



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr.542 prot.

Tiranë, më 01.02.2019

VENDIM

Nr. 3, datë 01.02.2019

Bazuar në Ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 38, Vendimin e Senatit Akademik nr. 2, datë 14.01.2019 “Për ngritjen e grupit të punës për të koordinuar vlerësimin lidhur me aktet nënligjore të miratuara”, Senati Akademik i UT-së, mbasi ka ndjekur me vëmendje aktet të cilat kanë dalë për efekt të zgjidhjes së situatës, mori në analizë materialin e paraqitur nga grupi i punës ku konstatoi se përveç disa veprimtarive të mira, pozitive, të disa akteve, ka edhe shqetësime lidhur me mbështetjen e disa akteve me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, në mbledhjen e datës 01.02.2019:

VENDOSI:

1. Të miratojë materialin e grupit të punës bashkëngjitur këtij vendimi.
2. T’i përcjellë për shqyrtim të mëtejshëm vlerësimet e grupit të punës Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

PROF.DR.MYNYR KONI

I. Vlerësim i VKM nr. 777, datë 26.12.2018, “Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore”

Kjo VKM është miratuar dhe ka hyrë në fuqi në shkelje me parashikimet e bëra nga LALKSH-i dhe Kushtetuta. Nga analiza e bërë kësaj VKM konstatojmë se ky akt ka shkelje procedurale dhe materiale.

1. Shkelje procedurale.

Kjo VKM është nxjerrë në shkelje të nenit 118 të Kushtetutës që parashikon se «1. Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë. 2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte». Asnjë nen i LALKSH-it nuk i njeh të drejtën Këshillit të Ministrave apo MASR të nxjerrë akte lidhur me kontrollin e plagjiaturës. Si rrjedhim, Këshilli i Ministrave nuk kishte kompetencën për të nxjerrë këtë VKM.

2. Shkelje materiale.

Fillimisht, sqarojmë se bazuar në nenin 7, pika 2/g të LALKSH, nuk është kompetencë e Ministrisë së Arsimit të mbajë kopje të njësuara me origjinalin të disertacioneve si dhe të bëjë kontrollin digjital antiplagjiaturë të tyre. Ministria e Arsimit administron vetëm regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë. Gjithashtu, edhe AKKSHI-ja si institucion publik në varësi të Ministrisë së Arsimit, sipas nenit 13 të këtij ligji, vetëm administron dhe përditëson listën e disertacioneve të doktoratave të mbrojtura dhe abstraktet përkatëse në një nga pesë gjuhët e BE-së.

E drejta e kontrollit antiplagjiaturë të disertacioneve nëpërmjet softwareve për kontrollin automatik i takon IAL-ve që kanë lëshuar gradat shkencore përkatëse. Për këtë qëllim rekomandojmë që Ministria e Arsimit të marrë masat e nevojshme për të ndihmuar IAL-të në blerjen e software-it të kontrollit automatik të plagjiaturës. Ky software do t'i shërbejë të gjithë komunitetit të kërkimit shkencor për kontrollin dhe vetë kontrollin paraprak të disertacioneve dhe produkteve të tjera të kërkimit shkencor. Theksojmë, që deri tani nuk ka ekzistuar një mekanizëm i tillë kontrolli për shkak të kostove të larta. Gjithashtu, deri tani nuk kanë ekzistuar rregulla sjelljeje që normojnë në mënyrë specifike etikën në kërkimin shkencor dhe në këtë kuadër, të japin një përkufizim të mirëpërcaktuar të konceptit të plagjiaturës. I vetmi akt nënligjor që përcakton plagjiaturën si shkelje e rëndë në etikën e kërkimit shkencor është Rregullorja „Për etikën në veprimtarinë kërkimore dhe botuese“ miratuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr.105, datë 23.03.2012. Edhe pse plagjiatura parashikohet në këtë urdhër, mungon një përkufizim i saj, dhe aq më tepër mungojnë kriteret e përcaktimit të plagjiaturës, format në të cilat realizohet, si dhe përcaktimet deri në çfarë mase ajo nuk ndikon në punimin apo kërkimin shkencor (siç parashikohet në shumë nga legjislacionet moderne). Pra, edhe parashikimi në këtë akt nënligjor nuk sjell asnjë pasojë ligjore për sa kohë nuk është përcaktuar ligjërisht nocioni i plagjiaturës. Gjithashtu, duhet të jenë IAL-të që të sigurojnë sisteme të kontrollit antiplagjiaturë jo vetëm për punimet e doktoratave, por edhe për punimet e studentëve: diploma, paper etj.

Për këto arsye, rivlerësimi i disertacioneve të mbrojtura duhet të kryhet duke pasur parasysh kuadrin ligjor rregullues dhe rregullat e etikës së kërkimit shkencor që kanë qenë në fuqi në kohën

kur është mbrojtur çdo disertacion. Për rrjedhojë, “rivlerësimi aposteriori” i gradave shkencore të mbrojtura, sipas standardeve të kërkimit shkencor që nuk kanë qenë të parashikuara në aktet e IAL-ve në fuqi në kohën e mbrojtjes së disertacionit është antikushtetues pasi cenon parimin e sigurisë juridike. Siguria juridike është ndër elementët thelbësorë të shtetit të së drejtës. Në kuptim të këtij parimi, rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme dhe si rregull, nuk mund të mohohen interesat dhe pritshmëritë e ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion. Shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë, vetëm nëse ndryshimi sjell pasoja pozitive. Sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, siguria juridike nënkupton, veç të tjerash, (i) garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin; dhe (ii) pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijimësinë e tyre. Për të kuptuar dhe zbatuar drejt parimin e sigurisë juridike, kërkohet, nga njëra anë, që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t’i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të dhe, nga ana tjetër, vetë ligji të mos qëndrojë statik nëse duhet t’i japë formë një koncepti siç është ai i drejtësisë në një shoqëri që ndryshon me shpejtësi. Një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit t’i japë asaj kuptime të ndryshme dhe që sjell pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma¹.

Në të njëjtën linjë edhe vendimi njehsues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 06.12.2013 afirmon se: “27. Parimi i gjykatës së caktuar me ligj, i të drejtës së ankimit, si dhe i sigurisë juridike janë ngushtësisht të lidhura me njëra tjetrën. Si element i sigurisë juridike, mbrojtja e pritshmërive të ligjshme nga rendi juridik ka të bëjë me të drejtën që kanë personat fizikë dhe juridikë për të gëzuar pasojat e pritshme të rendit juridik në fuqi në kohën kur ata ushtrojnë të drejtat e tyre të ligjshme. Për më tepër, kur këtyre personave i vijnë pasoja të pafavorshme nga ndryshimi i legjislacionit, ky i fundit nuk mund të veprojë me efekt prapaveprues. Parimi i përgjithshëm është se masat me efekte të pafavorshme dhe njëkohësisht prapavepruese janë të ndaluara dhe përjashtimet mund të parashikohen vetëm në rastet kur synohen të mbrohen interesa publike më të lartë dhe në raste të përcaktuara qartë nga ligjvënësi.”

Nisur nga sa argumentuam, sugjerojmë që lidhur me plagjiaturën duhet të hartohet një kornizë e plotë ligjore që të përcaktojë saktësisht nocionin e plagjiaturës, kriteret e përcaktimit të plagjiaturës, format në të cilat realizohet, si dhe përcaktimet deri në çfarë mase ajo nuk ndikon në punimin apo kërkimin shkencor, pasojat që sjell konstatimi i saj, mekanizmat e kontrollit etj. Përsa kohë mungojnë përcaktime të tilla ligjore është e paligjshme të parashikohen ndëshkime.

Përfundim: VKM nr.777, datë 26.12.2018 duhet të shfuqizohet ose të rishikohet me qëllim reflektimin e vërejtjeve të sipërpëmendura, dmth të mos cënojë autonominë e IAL-ve dhe parimin e sigurisë juridike.

¹ VGJK-20/08; VGJK-15/13; VGJK 5/15

II.VKM nr. 783, datë 26.12.2018 “Për vlerësimin e performancës në mësimdhënie të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë, edhe nëpërmjet sondazhit kombëtar të studentëve”

Nga analiza e bërë kësaj VKM konstatojmë se edhe ky akt ka shkelje procedurale dhe materiale.

Kjo VKM është nxjerrë në shkelje të nenit 118 të Kushtetutës që parashikon se «1. Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë. 2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte». Asnjë nen i LALKSHit nuk i njeh të drejtën Këshillit të Ministrave apo MASR të nxjerrë akte lidhur me vlerësimin e performancës në mësimdhënie të personelit akademik. Si rrjedhim, Këshilli i Ministrave nuk kishte kompetencën për të nxjerrë këtë VKM.

Pra, VKM-ja në fjalë është e paligjshme dhe e panevojshme. Ajo është në kundërshtim të hapur me nenet 14, 104 dhe 105 të LALKSHI-t, që përcaktojnë kompetencat e ASCAL. Theksojmë se vlerësimi i performancës së pedagogëve nuk është kompetencë e ASCAL. ASCAL monitoron dhe vlerëson periodikisht cilësinë e **institucionit** dhe të **programeve** të ofruara. Edhe lidhur me mësimdhënien, janë IAL-të ato që i nënshtrohen vlerësimit nga ASCAL dhe jo çdo pedagog i IAL-ve.

Gjithashtu, sipas nenit 104 pika 6 i LALKSHI, vlerësimi i jashtëm i cilësisë kryhet në përputhje me Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë. Sipas nenit 105 të tij, ky Kod është dokumenti kryesor për të gjitha proceset dhe procedurat e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Ai përcakton standardet shtetërore të cilësisë, të detyrueshme për zbatim prej institucioneve të arsimit të lartë. Kodi i Cilësisë të Arsimit të Lartë hartohet në ASCAL dhe Ministria përgjegjëse për Arsimin dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Ju bëjmë me dije, se ky Kod është miratuar me VKM nr. 531 datë 11.9.2018², si dhe në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr.186, datë 26.12.2018 është tashmë objekt rishikimi.

Duhet theksuar gjithashtu, që vlerësimi i performancës së personelit akademik është detyrë e çdo IAL-je nëpërmjet mekanizmave të brendshme të vlerësimit të cilësisë dhe përbëhet nga disa komponentë, ndër të cilët edhe mësimdhënia.

Për sa më sipër, VKM-ja në fjalë, duke i dhënë ASCAL kompetenca që nuk i gëzon me ligj, cënon autonominë e IAL-ve. Ajo gjithashtu rregullon çështje që rregullohen tashmë në bazë të Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë.

Përfundim: Propozojmë që VKM të ndryshohet duke u përshtatur me misionin e ASCAL, në funksion të vlerësimit institucional apo të programeve të studimit.

² Botuar në Fletoren Zyrtare n. 135/2018

III.VKM Nr. 781, datë 26.12.2018 “Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë”

Nga analiza e bërë kësaj VKM konstatohet se edhe ky akt ka shkelje proceduriale dhe materiale.

Kjo VKM është nxjerrë në shkelje të nenit 118 të Kushtetutës që parashikon se «1. Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë. 2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të cilave nxirren këto akte». Asnjë nen i LALKSHit nuk i njeh të drejtën Këshillit të Ministrave apo MASR të nxjerrë akte lidhur me realizimin e transparencës në IAL-të publike. Si rrjedhim, Këshilli i Ministrave nuk kishte kompetencën për të nxjerrë këtë VKM.

Gjithashtu, konstatohet se Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar nuk është subjekt i rregulluar në LALKSH. Për rrjedhojë, nuk mund t'i ngarkohen kompetenca një subjekti të paparashikuar nga ligji, aq më tepër kompetenca që ligji ia njeh vetë IAL-ve. Realizimi i transparencës është detyrë e IAL-ve dhe vetëm dhe vetëm ato duhet ta realizojnë. MASR mund të ushtrojë kontrollë periodike për të mbikëqyrur realizimin e kësaj detyre, por jo të ngrejë mekanizma për realizimin e transparencës, sepse nuk është kompetencë e saj ligjore (nuk parashikohet as në shkronjën «b» e as në shkronjën «e» dhe në asnjë shkronjë tjetër të nenit 7 të LALKSH).

Në VKM-në në fjalë ndër të tjera përcaktohet se:

“2. Portali të jetë i aksesueshëm nga të gjithë dhe në të të publikohen on-line:

gj) rezultatet e kontrollit dhe të verifikimit të titujve shkencorë;

h) mekanizmat dhe procedurat për bërjen e kërkesave dhe paraqitjen e ankesave në lidhje me veprimet ose mosveprimet e drejtuesve/ organeve drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë, procedurën, nëpërmjet së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të institucionit të arsimit të lartë.

3. Për trajtimin e ankesave në platformën e transparencës on-line, kontrollin e transparencës dhe pajtueshmërinë e veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë krijohet struktura përgjegjëse për kontrollin e transparencës së arsimit të lartë.”

Këto përcaktime janë në kundërshtim të hapur me parimin e autonomisë së IAL-ve, sepse ndërhyjnë në pushtetin e tyre për të marrë vendime në mënyrë të lirë e të pavarur për çështjet e transparencës.

Sikurse është shprehur Gjykata Kushtetuese: *“Parimi i autonomisë, në vështrimin historik, filloi të formësohet kur u krijuan universitetet si entitete të shkencës dhe studimit dhe kur lindi nevoja e autonomisë së tyre, që synoi të sigurote pavarësinë e universiteteve nga shteti. Qëllimi i kësaj autonomie ishte ruajtja e lirisë së shkencës, kërkimit shkencor dhe mësimdhënies, si dhe mbrojtja e studiuesve dhe profesorëve nga influencat politike etj., nisur nga ideja se shkenca dhe mësimdhënia, normalisht, mund të ekzistojnë dhe të sjellin progres vetëm kur janë të lira dhe të pavarura.*

Parimi i autonomisë universitare është i lidhur ngushtë dhe me parimin e lirisë akademike, i cili është shprehje e përpjekjeve për të mbrojtur, lirinë e mendimit shkencor të personave që

merren me kërkime shkencore dhe me mësimdhënie. Autonomia universitare është një formë institucionale e lirisë akademike dhe një parakusht për të garantuar përmbushjen e duhur të funksioneve që u janë besuar personelit mësimdhënës dhe institucioneve të arsimit të lartë. Autonomia universitare është thelbi i vetëqeverisjes, e nevojshme për vendimmarrjen efektive të institucioneve të arsimit të lartë në përmbushjen e detyrave akademike dhe arsimore.

Parimi i autonomisë universitare kërkon nga universitetet që të jenë subjekte të përgjegjshme dhe transparente në marrjen e vendimeve të tyre dhe në shpenzimet e fondeve. Kjo realizohet nëpërmjet mbikëqyrjes së veprimtarisë së universiteteve, nga organizma të ngarkuar për këtë qëllim, por kjo mbikëqyrje duhet të kryhet pa cenuar parimin e autonomisë universitare.

Respektimi i parimit të autonomisë së institucioneve të arsimit të lartë, të sanksionuar në nenin 57, pika 7, të Kushtetutës, kërkon që ligji të krijojë dimensione të tilla, që institucionet e arsimit të lartë të pajisen me pushtet të mjaftueshëm për të marrë vendime në mënyrë të lirë e të pavarur. Vetëqeverisja, kolegjaliteti dhe drejtimi i përshtatshëm akademik janë elemente thelbësore të autonomisë së vërtetë për institucionet e arsimit të lartë.”³

Përfundim: Lidhur me VKM Nr. 781, datë 26.12.2018 propozojmë rishikim të saj, duke respektuar gjithnjë autonominë e IAL-ve.

IV. URDHËR i KM nr.183, datë 26.12.2018 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për përzgjedhjen e literaturës së huaj që do të përkthehet me qëllim përdorimin në institucionet e arsimit të lartë”

Së pari duhet të theksojmë se në këtë urdhër nuk del qartë nëse literature që do të përkthehet do të shërbejë si literaturë e detyruar kryesore në programe të ndryshme që ofrojnë IAL-të apo do të jetë literaturë plotësuese, që ka për qëllim për të shtuar gamën e materialeve që u ofrohen studentëve për zgjerimin e horizonteve të tyre. Duhet të qartësohet kjo, sepse qëllimi i aktit ndikon drejtpërdrejtë në vlerësimin e aktit. Nëse qëllimi është pasurimi i literaturës në dispozicion të studentëve për zgjerimin e horizontit të tyre, akti është shumë i mirëpritur, i përgëzuar dhe i mbështetur nga të gjithë korpusi i pedagogëve.

Nëse qëllimi i aktit është përcaktimi i një literature të detyrueshme për çdo lëndë që ofrohet në programe të ndryshme studimi, me qëllim unifikimin e literaturës së detyrueshme për lëndët e njëjta në të gjitha IAL-të që ofrojnë të njëjtat programe, ndryshon qëndrimi ynë, sepse në parim një qëllim i tillë bie ndesh me parimin e “**Lirisë akademike dhe autonomisë të institucioneve të arsimit të lartë**”, sanksionuar në nenin 57, pika 7 të Kushtetutës dhe në nenin 3 të LALKSH, parim që ndër të tjera konsiston në të drejtën e institucioneve të arsimit të lartë për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe fushat e veprimtarisë kërkimore shkencore. Sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 9/2008, “Parimi i autonomisë universitare është i lidhur ngushtë me lirinë akademike dhe konsiston në ruajtjen e lirisë së shkencës, kërkimit shkencor dhe mësimdhënies, si dhe mbrojtja e studiuesve dhe profesorëve nga influencat politike etj., nisur nga ideja se shkenca dhe mësimdhënia, normalisht mund të ekzistojnë dhe sjellin progres vetëm kur janë të lira dhe të pavarura”.

Gjithashtu, ky Urdhër nuk gjen mbështetje në bazën ligjore që ai citon. Konstatojmë se: Neni 12 i ligjit nr. 9000/2003 përcakton ngritjen e grupeve të punës me ekspertë për hartimin e

³ VGJK Nr. 9, datë 19.03.2008

strategjive, politikave, studimeve dhe projekt-akteve të veçanta. Përzgjedhja e literaturës së huaj për përdorim nga institucionet e arsimit të lartë nuk përbën objekt për ngritjen e një grupi ndërinstytucional pune, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Ky objekt, “përzgjedhja e literaturës së huaj” nuk përfshihet edhe në rastet e grupeve të punës së ngritura nga KM sipas përcaktimeve të nenit 24/3 i ligjit 90/ 2012. Të dyja këto ligje i referohen bashkëpunimit dhe bashkërendimit mes institucioneve të administratës shtetërore, institucioneve shtetërore dhe njësisive të qeverisjes vendore (neni24/1 e ligjit nr. 90/2012). Ndërsa sipas neneve 6 dhe 3 të ligjit nr. 80/2015, institucionet e arsimit të lartë janë persona juridikë që ofrojnë arsimin e lartë ose profesional, si pjesë e arsimit të lartë dhe gëzojnë liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit sipas legjisllacionit në fuqi e nuk mund të jenë pjesë e grupeve të punës së ngritura nga KM.

Si përfundim, objekti i Urdhrit për “përzgjedhjen e literaturës së huaj” nuk gjen mbështetje në bazën ligjore të sipërcituar.

Pavarësisht qëllimit të tij, në këtë Urdhër ndeshen disa problematika të tjera:

Pika 2 në shkronjat d) dhe dh) të Urdhrit nr. 183 datë 26.12.2018 përcakton si anëtarë të grupit të ndërinstytucional të punës “përfaqësues nga institucione të arsimit të lartë” dhe “përfaqësues të studentëve, sipas fushave të studimit”. As në këtë pikë të Urdhrit dhe as në ndonjë tjetër nuk përcaktohen kriteret dhe modalitetet e përzgjedhjes dhe autoriteti që do t’i caktojë, si për grupin e punës, ashtu edhe për nëngrupet e punës së përcaktuara në pikën 3 të Urdhrit.

Pika 6 e Urdhrit është e paqartë në lidhje me ftesën për pjesëmarrje të institucioneve të tjera (cilat institucione përfshihen???) dhe studentët. Pikat 5 dhe 6 të Urdhrit nuk qartësojnë rolin e të ftuarve në grupin dhe nëngrupet e punës.

Po kështu, është e pakuptueshme se pse studentët duhet të jenë sipas fushave, ndërsa nuk parashikohen pedagogë sipas specifikimeve konkrete. Është e paimagjinueshme që literatura edhe ndihmëse po të jetë, të zgjidhet nga studentët që nuk kanë formimin e duhur profesional dhe shkencor për të bërë një përzgjedhje të tillë. Ata mund të ndihmojnë, por nuk mund të jenë faktor përcaktues. Të vetmit faktor përcaktues duhet të jenë pedagogët specialistë të lëndës për të cilën po përkthehet literatura. Studentët mund të hyjnë në vlerësim vetëm duke zgjedhur ndërmjet disa teksteve të selektuara më parë nga specialistët. Vetëm kështu ky proces do të jepte rezultatet maksimale të pritshme.

Përfundim: Sugjerojmë që të gjitha plotësimet e nevojshme që bëhen me akte të mëtejshme të MASR, për ta bërë më efikas këtë urdhër, pa cënuar autonominë e IAL-ve.

V.URDHËR i KM 185, datë 26.12.2018 “Për ngritjen e grupit ndërinstytucional të punës për hartimin e modelit të statutit për IAL-të publike”

Nëse synohet që nëpërmjet këtij grupi pune të hartohet një akt për rubrikat dhe nënrubrikat që duhet të përmbajë një statut, me qëllim unifikimin e problematikave që duhet të rregullojë një statut IAL-je për të qenë s më i plotë dhe eficient, është një iniciativë që duhet të përgëzohet dhe

sugjerojmë që të ketë sa më shumë specialist të arsimit të lartë dhe juristë njohës të problematikave të arsimit të lartë me të cilët të konsultohet modeli i statutit,

Nëse synohet në hartimin e një statuti unik për të gjitha IAL-të publike, konstatohet se Urdhri është në kundërshtim me LALKSH dhe konkretisht me:

Nenin 2: **Qëllimi i ligjit**, që përcakton rolin e shtetit në Arsimin e Lartë;

Nenin 3: **Liria akademike dhe autonomia e IAL-ve** dhe

Nenin 5: **Roli i shtetit në Arsimin e Lartë**, i cili ka funksione rregullatore dhe garanton autonominë, është përgjegjës për përcaktimin dhe monitorimin e standardeve në IAL.

Përfundim: E gjejmë të tepërt këtë urdhër. Sugjerojmë shfuqizimin e këtij si të panevojshëm.

VI.VKM Nr. 778, datë 26.12.2018 “Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 288, datë 21.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”, të ndryshuar”

Nga analiza e bërë kësaj VKM konstatohet se ky akt nuk ul tarifën maksimale vjetore të shkollimit për programet e ciklit të parë të studimeve dhe ato të integruara, të përcaktuara në VKM NR. 288, datë 21.5.2018. Kjo është pozitive për IAL-të publike, sepse po të ulej tarifa maksimale e shkollimit, që neni 7, pika 2, shkronja f e LALKSH ia lë kompetencë VKM për ta përcaktuar, atëherë kjo do të ndikonte ndjeshëm në të ardhurat që IAL-të krijojnë nga mbledhja e këtyre tarifave, duke i përgjysmuar ato. Për plotësimin e kërkesave të studentëve për përgjysmim të tarifës, është zgjedhur mekanizmi i ruajtjes së pandryshuar të tarifës dhe e pagesës nga Qeveria të pjesës që nuk paguhet nga studentët, pra e rimbursimit të kësaj pjese.

Për vitin akademik 2018-2019 e në vazhdim, si rregull, të gjithë studentët do të paguajnë në programet e ciklit të parë të studimeve dhe atij të integruar vetëm 50 % të tarifës.

Duke filluar nga viti akademik 2019-2020 e në vazhdim, studentët që mbarojnë vitin e parë me mesatare nën 6, do të paguajnë për vitet në vazhdim tarifën e plotë. Studentët në hyrje trajtohen të gjithë të barabartë për vitin e parë të shkollës (paguajnë 50% të tarifës), ndërsa trajtimi i tyre në vitet në vazhdim bëhet në bazë të meritës. Ky rregullim është në përputhje me nenin 57, pika 4 të Kushtetutës, i cili përcakton se “Arsimi i mesëm profesional dhe i lartë mund të kushtëzohet vetëm nga kritere aftësie”.

Studenti Kristian Kina, anëtar i komisionit, ka ngritur pretendimin që edhe për kategorinë e studentëve me mesatare të vitit të parë nën 6 duhet të parashikohet pagesë 50% e tarifës së shkollimit.

Përfundim: Mbështesim këtë VKM dhe nuk konstatojmë probleme të tij.

VII.VKM Nr. 779, datë 26.12.2018 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 269, datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, të ndryshuar”

Nga analiza e bërë kësaj VKM konstatojmë se ky akt ka për qëllim të përcaktojë se cilat kategori studentësh, bazuar në nenin 57, pika 4 të Kushtetutës, i cili përcakton se “Arsimi i mesëm profesional dhe i lartë mund të kushtëzohet vetëm nga kritere aftësie”, përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit, duke përcaktuar si të tillë:

1. Studentët që rezultojnë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë). Kjo kushtëzohet nga fakti që këta studentë duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për vitet e mëparshme të programit të studimit përkatës, brenda përfundimit të vitit akademik paraardhës;
2. Studentët e pranuar në vitin e parë akademik në institucionet publike të arsimit të lartë, me notë mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë) nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë, të përlogaritur si mesatare e notave të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, përfshirë edhe rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore.

Qeveria merr përsipër rimbursimin e tarifës së shkollimit të këtyre kategorive studentësh në programet e ciklit të parë dhe programet e integruara, gjë që nuk çënon financat e IAL-ve publike.

Studenti Kristiano Kina, ka ngritur pretendimin që ky trajtim në bazë të rezultateve do të stimulojë korrupsionin dhe fiktivitetin e notës. Nuk u mbështet, sepse edhe më parë studentët ekselentë janë përjashtuar nga tarifat e shkollimit.

Përfundim: Mbështesim këtë VKM dhe nuk konstatojmë probleme të tij.

VIII.VKM Nr. 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë”

Nga analiza e bërë kësaj VKM konstatojmë se ky akt ka për qëllim të përcaktojë se cilat kategori studentësh të ciklit të dytë të studimit do të përfitojnë ulje të tarifës vjetore e shkollimit. Duhet theksuar se LALKSH nuk parashikon vendosje të tarifës maksimale nga qeveria për programet e ciklit të dytë dhe të tretë, duke ia lënë përcaktimin e këtyre tarifave vetë IAL-ve

publike. Ligji është ndërtuar mbi konceptin se me marrjen e një diploma të ciklit të parë, student mund të punësohet, duke përballuar vetë koston e plotë të studimeve të ciklit të dytë. Ky është koncepti mbi të cilin është bërë ndarja në cikël të parë dhe të dytë studimi, sipas Kartës së Bolonjës. Në Këtë VKM janë përcaktuar si kategori përfituese të uljes të tarifës së shkollimit në masën 50% në programet e ciklit të dytë:

1. Studentët me aftësi të kufizuara
2. Studentët, familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore, si dhe studentëve deri në moshën 25 vjeç, që kanë vetëm njërin nga prindërit, pasi prindi tjetër është ndarë nga jeta, me të ardhura vjetore të familjes të pamjaftueshme për përballimin e koston të studimeve
3. Studentët, që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç;
4. Studentët deri në moshën 25 vjeç, që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykate të formës së prerë;
5. Studentët deri në moshën 25 vjeç, që janë identifikuar si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore;
6. Studentët fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës, të konfirmuar nga ministria/institucioni përgjegjës;
7. Studentët romë dhe ballkano-egjiptianë
8. Studentët fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;
9. Studentët që fillojnë vitin e parë të ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë);
10. Studentët që rezultojnë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), të regjistruar në vitin e parë pas të parit dhe që kanë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për vitin akademik paraardhës.

Këto janë politika sociale që ka vendosur të ndjekë Qeveria, duke rimbursuar 50% të tarifës që nuk paguan studenti. Në këtë formë nuk cënohen të ardhurat e IAL-ve publike që vijnë si rezultat i pagesave të tarifave të shkollimit në programet e ciklit të dytë.

Studenti Kristiano Kina, ka ngritur pretendimin që tu zbritet tarifa edhe studentëve që janë me mesatare më të ulët se 9, ose të ketë përshkallëzim: me mesatare 7-9 të kenë 30% zbritje, me mesatare 5-7 të kenë 20% zbritje. Ky pretendim nuk ka një mbështetje ligjore, nisur nga fakti që

në programet e ciklit të dytë studentët paguajnë tarifën e përcaktuar nga IAL-ja publike përkatëse, që, si rregull, përputhet me koston e plotë të studimit për këto programe.

Përfundim: Mbështesim këtë VKM dhe nuk konstatojmë probleme të tij.

IX.VKM Nr. 782, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të bordit të administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”

Nga analiza e bërë kësaj VKM konstatojmë se ky akt ka për qëllim të përcaktojë kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të Ministrisë.

Në përgjithësi përzgjedhja e këtyre anëtarëve bëhet nëpërmjet një konkurrimi publik. Një nga përfaqësuesit e Ministrisë përzgjidhet ndërmjet 3 kandidaturave të propozuara nga studentët. Duhet theksuar se ky anëtar i Bordit të administrimit nuk është student, por i propozuar nga studentët.

Përfundim: Mbështesim këtë VKM dhe nuk konstatojmë probleme të tij.

X.VKM Nr. 784, datë 26.12.2018 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 903, datë 21.12.2016, të këshillit të ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, të ndryshuar”

Nga analiza e bërë kësaj VKM konstatojmë se ky akt ka për qëllim të përcaktojë kriteret për të përfituar bursa studimi studentët e ekselencës, që sipas kësaj VKM janë:

1. Studentët që fillojnë studimet në ciklin e parë të studimeve ose në atë të integruar në IAL-të publike, kur kanë mesatare të shkollës së mesme të lartë, përfshirë edhe provimet e maturës shtetërore, mbi 9.
2. Studentët e regjistruar në çdo program studimi, në vitet pas të parit, me kriterin e notës mesatare mbi 9 (nëntë), të përlloritur nga institucionet e arsimit të lartë, vetëm për periudhën që ndjekin studimet në këto programe studimi dhe për kohëzgjatjen normale të programit të studimit.

Konstatohet se është zgjeruar rrethi i studentëve që përfitojnë bursa studimi.

Përfundim: Mbështesim këtë VKM dhe nuk konstatojmë probleme të tij.

XI.URDHËR i KM 184, datë 26.12.2018 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për përgatitjen e ngritjes dhe të funksionimit të kampusit universitar të Tiranës”

Përgëzojmë iniciativën e këtij akti që synon në finalizimin e një prioriteti të UT-së, ngritjen e kampusit universitar.

Përfundim: Mbështesim këtë Urdhër dhe nuk konstatojmë probleme të tij.

XII.URDHËR i KM 186, datë 26.12.2018 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për rishikimin e Kodit të Cilësisë së arsimit të lartë”

Përgëzojmë iniciativën e këtij akti që përkon edhe me kërkesat tona për rishikimin e akteve të dala në zbatim të LALKSH.

Përfundim: Mbështesim këtë Urdhër dhe nuk konstatojmë probleme të tij.